

VENDIM
Nr. 99, datë 28.7.2015

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “DENAS POWER” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 germa “d” dhe 39 pika 3, dhe nenit 110 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “g”; 5, pika 2; 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1 germa “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr. 21 datë 18.3.2009 të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Denas Power” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie;

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4./10 germa “c”). Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti rezulton se shoqëria “Denas Power” sh.p.k. nuk ka realizuar kontrata të mëparshme.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Sasinë e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar (neni 9, pika 4/10, germa “a”); dhe
- Kapitalin financiar të deklaruar nga shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti, (neni 9, pika 4/10 germa “b”),

do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin shoqërisë “Denas Power” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Kundërshtimet e palëve të interesuara ndaj këtij aplikimi mund të bëhen brenda 10 ditëve kalendarike nga botimi në gazetë i njoftimit për vendimarrjen e Bordit të ERE-s mbi fillimin e procedurave të licencimit të këtij subjekti.

3. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti